

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rolando Maran rrëfen jetën në Shqipëri: Nga “avash-avash” te tavë dheu, ndihem si në shtëpinë time
ADRESA	https://albeu.com/sport/rolando-maran-rrafen-jeten-ne-shqiperi-nga-avash-avash-te-tave-dheu-ndihem-si-ne-shtepine-time/1010705/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:57:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 10:56:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	618e96f136efa05b813eafb3704fa58dc92917b67857f08c4aae7f45bdf62402
TEKSTI	23a286788275dd971b2da4b36679ca69a708228c4e4601e10c8067d37f858113
PAMJA	44076392a89221ebf53691e849a5626d62d13287fb6043b4e57059b139753cbf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f75e2a37c58425fad56a20e319cb2865c742a4c072315bfed929b7657b0e72ed
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f75e2a37c58425fad56a20e319cb2865c742a4c072315bfed929b7657b0e72ed>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rolando Maran rrëfen jetën në Shqipëri: Nga “avash-avash” te tavë dheu, ndihem si në shtëpinë time



Jeta e përditshme, dashuria për natyrën, familja, miqtë dhe koha e lirë janë disa nga temat për të cilat ka folur trajneri i Kombëtares shqiptare, Rolando Maran, në një intervistë për fshef.org.

Tekniku kuqezi ndau gjithashtu përshtypjet e tij për Shqipërinë, mikpritjen shqiptare, ushqimin tradicional, fjalët e para që ka mësuar në shqip dhe vlerat që dëshiron t'ua përcjellë futbollistëve të përfaqësueses.

Maran tregon se zakonisht zgjohet rreth orës 7 të mëngjesit, ndonëse ndonjëherë mund të jetë edhe më herët. Sapo nis ditën, kërkon të dalë në një hapësirë të hapur, qoftë duke hapur një dritare, duke dalë në terracë apo në kopsht.

Pas mëngjesit, niset drejt Federatës. Ai nuk ka një orar të përcaktuar mbërritjeje, por zakonisht shkon atje pas shëtitjes së tij dhe nis përgatitjet për ndeshjet e ardhshme.

Për Maran, futbolli është mbi të gjitha një pasion. Ai thotë se dashuria për këtë sport ka nisur që në fëmijëri, kur ëndërronte të bëhej futbollist. Pasi e realizoi këtë synim, ai u bë trajner dhe sot drejton Kombëtaren shqiptare, një detyrë që e mbush me krenari.

“Puna ime lind nga pasioni, ndaj më pëlqen gjithçka në të. Nuk ka asgjë në punën time që nuk më pëlqen”, shprehet trajneri.

Kur ka kohë të lirë, Maran preferon të qëndrojë në natyrë dhe në ambiente të hapura. Aktivitetet ndryshojnë sipas stinës: gjatë dimrit kërkon vende me sa më shumë borë, ku mund të bëjë edhe ski. Shëtitjet, koha me familjen dhe takimet me miqtë janë pjesë e ditës së tij ideale.

të fundit /



Berisha pas kthimit nga SHBA: Edhe pas 35 vitesh u paraqita si...



VIDEO/ Publikohen pamjet nga dhuna e policisë ndaj...



Ambasada amerikane njofton për protesta në Kosovë para vendimit...



Prokuroria: Thaçi synoi të drejtonte dëshminë e Zyrarit, jo thjesht ta...



Pasaporta e Maqedonisë së Veriut renditet e 38-ta, ...



Volkswagen prezanton teknologjinë për ndërrim automatik të...



Media italiane Corriere della Sera: Nga kundërshtimi ndaj...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

muajt e pare ne Shqiperi nuk kane sjelle nje surprize te mireme per te, por nje konfirmim te asaj qe kishte degjuar me heret per mikpritjen shqiptare. Sipas tij, shqiptaret e kanë tejkaluar çdo përshkrim që ishte bërë.

"Ndiem si në shtëpi. Më keni bërë të ndihem si miku juaj prej gjithmonë. Për mua kjo është më shumë se një cilësi; është vërtet diçka befusuese", rrëfen Maran.

Trajneri thotë se ende nuk mund të veçojë një gjë të caktuar si më "shqiptaren" që ka mësuar. Ai dëshiron të njohë më shumë aspekte të vendit dhe thekson se është ende herët për të dhënë një përgjigje të saktë, pasi nuk i pëlqen të flasë pa qenë i bindur për atë që ndien.

Ajo që e ka vlerësuar veçanërisht te shqiptarët është vendosmëria dhe forca me të cilën përballen me gjërat. Maran e konsideron këtë një vlerë të madhe dhe dëshiron t'ua transmetojë edhe lojtarëve të Kombëtares, pasi e sheh si pjesë të ADN-së së futbollistit dhe të popullit shqiptar.

Sa u përket zakoneve vendase, ai pranon se nuk ka adoptuar ende shumë prej tyre. Megjithatë, po përpiqet të afrohet gjithnjë e më tepër me shqiptarët dhe të kuptojë më mirë vendin, i cili, sipas tij, ka shumë gjëra të bukura dhe aspekte që i kanë ngjallur kureshtje.

Mes gatimeve tradicionale, pjata që i ka pëlqyer më shumë është tava e dheut. Maran e përmend me humor, duke pranuar se shqiptimi i tij mund të mos ketë qenë i përsosur, por shija i ka lënë përshtypje të veçantë.

Fjala e tij e preferuar në shqip është "avash-avash". Ai thotë se nuk ka një arsye të veçantë për këtë zgjedhje, përveç faktit se i pëlqen mënyra se si tingëllon.

Ndërsa fjala që e ka më të vështirë të shqiptojë është "përsëndetje". Maran shpjegon se për italianët është shumë më e thjeshtë të përdorin "Ciao", ndërsa kjo përsëndetje në shqip i duket më e ndërlikuar, ndaj preferon ta thotë në italisht.

Edhe shprehja "Çkemi?" i duket edhe më e vështirë për t'u shqiptuar, ndaj, siç thotë vetë, ka vendosur të heqë dorë fare prej saj.

Shtuar më 14.09.2026 12:56

Tags: kombetarja , rolando-maran , trajneri-i-shqiperise



Vllaznia në krizë pas 4 javësh, kalendari i ardhshëm e vë përballë n...



Abelardo kritikon deklaratat e Mbappes dhe Yamalit për Topin e Artë: "Messi nuk ...



Pas vetëm 4 javësh, Teuta e Edlir Tetovës merr kreun dhe sfidon rivalët e...



Yamal ngre zërin për Topin e Artë: Unë dhe Mbappe jemi më të mirët, çmimi ...



Xherdan Shaqiri shpërthen ndaj Luzernit dhe përfshihet në formacionin ideal të...



Dopieta e Shpendit në Serinë B, Asani dhe Tuci gjithashtu protagonistë n...



Superliga e Kosovës vazhdon me dy përballje mjaft interesante



T'i bjerë kokës", plas kritikrat ndaj Florin Bratut te Partizani: S'mund të bëjë...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj

Kategori

Lifestyle

Linqet

Live tv shqiptare

Tags

Edi Rama

Moti

Moti në Tiranë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.